


**Miratohet vendimi për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 910 datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për çështjet, objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore i ndryshuar”**



Këshilli i Ministrave ka miratur Vendimin Nr. 456, datë 10.6.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 910 datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për çështjet, objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar”. Sipas vendimit, në kuadër të funksioneve të bashkive, do të shtohet edhe fusha për diasporën dhe migracionin si dhe në pikën 7 të Kreut III, “Krijimi, përbërja dhe drejtimi i Këshillit Konsultativ”, shtohen nënndarjet, me këtë përmbajtje: “Përfaqësuesi i ministrit përgjegjës për marrëdhëniet me diasporën; Përfaqësuesi i ministrit përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes”. Krijimi i strukturave administrative me fokus fushën e migracionit synon mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm dhe forcimin e marrëdhënieve me anëtarët e Diasporës shqiptare, të cilët kanë vendlindjen ose origjinën nga territori që ato mbulojnë.

**Aplikacioni informues “Diaspora Shqiptare”**



App store [këtu](#); Play store [këtu](#)

**Qendra e Botimeve për Diasporën, mbledhje online me mësuesit shqiptarë në Suedi dhe Finlandë**



Qendra e Botimeve për Diasporën në vijimësi të mbledhjeve të organizuara online me përfaqësuesit e mësuesve në Diasporë, me qëllim marrjen e informacionit dhe njohjen e problematikave të mësimdhënies në Diasporë, të lindura nga situata e re dhe jo vetëm, zhvilloi sot mbledhjen me mësues të gjuhës dhe kulturës shqiptare në Suedi dhe Finlandë. Të pranishmit sollën përvijën e arsimit në vendet skandinave, të cilat kanë një qasje mbështetëse ndaj gjuhës dhe kulturës së të ardhurave nga vendet e tjera, metoda të përparuara arsimimi e integrimi dhe një organizim të financuar për gjuhët amtare përmes institucioneve shtetërore. Ata diskutuan gjithashtu nevojën e mbështetjes nga vendi amë, sidomos në ofrimin e teksteve cilësore, të mirëmbledhura në përshtatje me nevojat e komunitetit shqiptar në diasporë dhe në përputhje me kërkesat e kohës. Në mbyllje të këtyre takimeve të realizuara online me mësuesit e gjuhës dhe kulturës shqiptare në Diasporë, Qendra e Botimeve për Diasporën po përgatit një relacion të detajuar, me qëllim marrjen e masave dhe hartimin e një politike mbështetëse dhe bashkëpunimi me shkollat shqipe në diasporë

**Aplikacioni gazeta “Diaspora Shqiptare”**

SHKARKO APLIKACIONIN FALAS



App store [këtu](#); Play store [këtu](#)

**Zhvillohet mbledhja e dytë e këshillit koordinues të QSPA-së**

Në mjediset e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, u zhvillua mbledhja e dytë e Këshillit Koordinues. Drejtoresha e Qendrës, prof. Diana Kastrati paraqiti relacionin me projektet propozimet (të cilat u ishin dërguar paraprakisht me mail anëtarëve të Këshillit Koordinues). U diskutua mbi botimin e dy veprave me karakter studimor. Në vijim u paraqit projekti për botimin e revistës shkencore, e cila do të mbajë titullin “Continuum” që semantikisht simbolizon vijimin, mosndërprejjen e historisë tonë të përbashkët. Do të përmbajë nga një studim të studiuesve të Qendrës, si dhe kontribute, gjykime nga studiues me emër mbi një temë të caktuar. Në fund, do të vendoset edhe një buletin informativ mbi aktivitetin kërkimor studimor të secilit studiues të Qendrës.



**“Raporto” problemin në çdo kohë në Ambasadalme**



App store [këtu](#); Play store [këtu](#)

**Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën miraton projektet e reja të QBD-së**

Qendra e Botimeve për Diasporën e drejtuar nga znj. Mimoza Hysa organizoi mbledhjen e radhës me Këshillin Koordinues të Botimeve për Diasporën. Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën diskutoi dhe miratoi: 1. Listën e kërkesave për tekste shkollore dhe literaturën shtesë për vitin shkollor 2020-2021; 2. Botimin dygjuhësh me 10 tregime nga vëllimi “Tregime të moçme shqiptare”, të Mitrush Kutelit; 3. Botimin e lojës “Mos u nxeh”, pjesë e projektit “E ka kush e ka”, hartuar nga Organizata ndërkombëtare CHWB; 4. Botimin e revistës letrare “Letra nga Diaspora”.



**Drejtoresha ekzekutive e QBD-së, intervistë për emisionin “Tempull”**



Në një intervistë për televizionin RTSH në emisionin “Tempull”, Drejtoresha Ekzekutive e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Mimoza Hysa, flet për sfidat e mësimit të shqipes dhe roli i Qendrës së Botimeve për Diasporën si faktor nxitës e ndihmues. Vizioni, projektet dhe angazhimi i saj për të qenë një ndërmjetës i rëndësishëm në përhapjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare në Diasporë.

**Drejtoresha ekzekutive e QSPA-së, intervistë për televizionin RTSH**



Drejtoresha ekzekutive e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA), prof. Diana Kastrati, në një intervistë për televizionin RTSH në emisionin “Tempull”, të gazetares Anisa Ymeri, ka prezantuar disa nga objektivat dhe projektet kryesore për vitin 2020 në institucionin që drejton. Duke theksuar faktin se në të gjithë historinë e shtetit shqiptar, kjo është hera e parë që themelohet një institucion i posaçëm mbi arbëreshët, ajo ka shpalosur vizionin dhe punët kryesore mbi të cilat është përqendruar puna kërkimore-shkencore e stafit të këtij institucioni.

**KKD / Mark Gjonaj takim me bizneset e vogla në New York**

Mark Gjonaj, kryetar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe njëkohësisht këshilltar i Bashkisë së New York-ut, ka zhvilluar një takim me bizneset e vogla të komunitetit ku ai është këshilltar. Në kuadër të rihapjes së bizneseve pas izolimit për shkak të pandemisë Covid-19, në takim z. Gjonaj diskutoi me pronarët e bizneseve rreth gjendjes ekonomike dhe sfidave të fazës së rihapjes, i shoqëruar dhe nga Presidenti i Dhomës së Tregtisë në Bronx e ekspertë të tjerë fushës së biznesit në New York.



**KKD / Lazim Destani: Diaspora gjithmonë me sy nga shqiptaria**

Anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe përfaqësues i “Ecolog”-ut, Lazim Destani së bashku me Remzi Ejupi nga “Eurokoha” dhe Nazmi Viqa nga “Abbruch AËR”, kanë dorëzuar në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike 15 mijë teste për COVID-19. Destani shprehet se personeli mjekësor në Kosovë ka bërë punë të madhe në menaxhimin e pandemisë si dhe theksoi se Diaspora vazhdimisht sytë i ka nga shqiptaria.

